



# Edi Rama


KRYEMINISTËR I SHQIPËRISË

## Deklaratat e analizuara:

16 Deklarata te analizuara  
(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2018)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklaramit deri në vitin 2018

### Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite



Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2018 është rritur

+ 6,310,575 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Bankë

17,290,820

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2018

3,500,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2018

Likuiditete në Cash

182,000

Huadhënie

9,713,900

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2018

Pasuritë e Luajtshme

400,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2018

2,516,690

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2018

Pasuritë e Paluajtshme

73,088,589

## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2018	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga nga funksioni	25,610,756	27.1%
Të ardhura nga puna e bashkëshortes	36,469,140	38.6%
Të ardhura nga djali, nga shitja e veprave të artit	7,570,501	8.0%
Të ardhura nga shitja e librit "Kurban" dhe veprimtaria artistike	8,963,314	9.5%
Të ardhura nga qeraja	15,652,654	16.6%
Të ardhura të tjera	105,642	0.1%
<b>Total</b>	<b>94,372,008</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

1 Me probleme  
13 Pa Probleme

Edi Rama ka shkëputje nga funksioni publik dhe detyrimi ligjor për të deklaruar pasurinë nga korriku 2011 deri në shtator 2013. Pas zgjedhjes si kryeministër, Rama dhe bashkëshortja e tij rideklarojnë pasurinë e plotë në tetor 2013, e cila është shtuar me 44,736,099 lekë krahasuar me vitin 2011. Ndërkohë, burimet e deklaruara në rubrikat përkatëse janë të pamjaftueshme për të mbuluar shtesën e aseteve në shumën 29,641,593 lekë.

Në të njëjtën periudhë është ndërtuar shtëpia e banimit 1 kat në komunën Dajt, me vlerë 39,607,741 lekë në bashkëpronësi me bashkëshorten. Subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI dokumente shtesë si leje ndërtimi dhe dokumente mbështetëse për burimin e krijimit, por në rubrikat përkatëse të formularit që BIRN disponon, nuk është deklaruar burimi i krijimit. Në tetor 2013, subjekti deklaron se ka një detyrim të pashlyer ndaj shoqërisë së ndërtimit në shumën 12,056,241 lekë "në pritje të miratimit të një kredie bankare". Kredia bankare me vlerë 80,000 euro është lëvruar më 22 tetor 2013, me afat shlyerje 10 vjet.

Bashkëshortja Linda Rama deklaron për herë të parë pasurinë në vitin 2010, bashkë me dy kontrata huadhënieje pa interes në vlerat 30 mijë euro dhe 40 mijë euro. Këto hua nuk rezultojnë të jenë kthyer deri në fund të vitit 2017.

Në vitin 2012 është bërë rivlerësimi i apartamentit të banimit 'parafabrikat 1 + 1, me sip 59 m<sup>2</sup>', përfituar nga privatizimi, sipas çmimit fiskal në vlerën 5,422,000 lekë. Apartamenti është shitur në vitin 2017 në shumën 5,000,000 lekë.

